

Fqinjti i Derës Ngjitur

Vlerat Respekti, Njohuria, Toleranca *Fleta e Mësuesit*

Baza ligjore Nenet 1, 7, 11, 21, 22, 25, 26 (Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian); Neni 2 (Traktati i Lisbonës)

Qëllimet **Pedagogjike:** Reflektimi mbi rëndësinë e fqinjëve për jetesën në komunitet.
Praktike: Plotësimi i tabelës ku analizohen fjalët e urta në lidhje me fqinjësinë.

Pjesëmarrësit Minimumi 3; Maksimumi 30.

Kohëzgjatja 30 deri 45 minuta


Materialet Fleta e aktivitetit për secilin student

Përmbledhje Fillimisht, nxënësit reflektojnë individualisht mbi konceptin e “fqinjtit”: rëndësinë e tij dhe cila është marrëdhënia e tyre me fqinjët duke plotësuar fletën e aktivitetit të nxënësit. Në një moment të dytë, çdo student ndan me klasën përfundimet e tij/saj, duke prezantuar rezultatet e fletës së plotësuar.

Shënime Ndërkohë që nxënësit paraqesin reflektimet e tyre, mësuesi/ja mund të shkruajë temat kryesore për të mbështetur fazën e diskutimit. Sugjerohet të konsultohen faqet e internetit më poshtë për më tepër informacion rreth Ditës Europiane të Fqinjësisë - <http://www.european-neighbours-day.com> dhe rreth politikës së zgjerimit dhe fqinjësisë - http://europa.eu/abc/12lessons/lesson_3/index_en.htm.

Diskutimi Mësuesi/ja duhet të analizojë me nxënësit temat e paraqitura prej tyre, duke moderuar debatin rreth çështjeve si:

*I njihni fqinjët në ndërtesën/lagjen tuaj? Sa mendoni se i njihni ata?
E konsideroni veten një fqinj të mirë me ta? Justifiko përgjigjet e tua.
Keni pasur ndonjëherë nevojë të kërkonti ndihmë nga një fqinj apo ndonjë fqinj ka kërkuar ndihmën tuaj? Nëse po, në cilat situata?
Si mund t'i lidhim këto çështje me rëndësinë e fqinjësisë së mirë në Bashkimin Evropian?
Mund të flisni lidhur me ndonjë bashkëpunim të mirë apo të dobët në Bashkimin Evropian? (eksploroni, për shembull, solidaritetin midis shteteve për të mbuluar borxhet, menaxhimin e kufijve dhe emigracionin, etj).
Nëse do të kishit rast të flisni me dikë nga një Institucion Evropian në lidhje me këtë çështje, çfarë do t'i thonit apo propozonit?*



Fqinji i Derës Ngjitur

Fleta e Nxënësit

Interpretoni dhe komentoni fjalët e urta si më poshtë:

Ai që ka një komshi të mirë ka një mëngjes të mirë.

Ai që ka çati prej xhami nuk duhet të hedhi gura në çatitë e të tjerëve.

Reflektoni rreth...

Rëndësisë e të jetuarit në komunitet.

Marrëdhënieve me komshinjtë tuaj.

